

**RELACION TEKNIK**  
**PER**  
**RIKONSTRUKSION UJESJELLESI,**  
**ZEVENDESIM I RRJETI KRYESOR DHE RRJETIT SHPERNDARËS**  
**LAGJJA DYLI HAXHIRE (NSHU) , RR. KONGRESI PERMETIT**  
**BASHKIA ELBASAN**

**Objekti i ndertimit** – Rikonstruksion ujesjellesi, zevendesim i rrjeti kryesor dhe rrjetit shperndares Lagja Dyli Haxhire (NSHU) , Rr. Kongresi Permetit.

**Vendi i ndertimit** – Bashkia Elbasan

**Qellimi i ndertimit** – Permiresimi i furnizimit me uje dhe kushteve higjeno sanitare te banoreve te Lagjes Dyli Haxhire ,NSHU

Hartimi i projektit eshte mbeshtetur si me poshte :

**I.- Gjendja ekzistuese e furnizimit me uje te pijshem e Lagjes Dyli Haxhire (NSHU).**

**II.- Detyra e projektimit dhene nga sh.a. UKE Elbasan**

**III.- Zhvillimi i projektit per rikonstruksion ujesjellesi**

**I- Gjendja ekzistuese sistemit te ujesjellesit e Lagjes Dyli Haxhire (NSHU).**

**Gjendja ekzistuese:**

Qyteti i Elbasanit furnizohet nga puset e ujit qe ndodhen ne zonen e Krastes se Vogel, Ne Mengel dhe tek Ish Frigoriferi. Lagjia Dyli Haxhire furnizohet nga tubacioni Dj200 PE i cili kalon prane rruges Kongresi i Permetit qe eshte edhe zona e projektit. Kjo rruge furnizohet me ane te nje tubacioni Dj 90 PE i cili eshte i lidhur me nje elektropomp centrifugale uji ne fillim te rruges me parametra  $N = 17 \text{ KW}$ ,  $Q = 5 \text{ l/s}$ ,  $H = 150 \text{ m}$  me kuot  $126 \text{ m}$ .

Pompa per momentin eshte pothuaj jashte pune per shkak te amortizimit.

Ne kete rruge jane kryer investime me pare nga Sh.a. UKE por nuk ka patur permiresim te

ndjeshem te situates se furnizimit me uje edhe per shkak te nderhyrjes se banoreve ne tubacione dhe ne sistemin e matjes se ujit.

Gjithashtu problem eshte edhe koha e furnizimit e lagjes me uje e cila eshte 2 here ne dite nga 2 ore. Mungesa e nje depo uji ben qe uji te konsumohet me shpejtesi dhe ne maksimum dhe per kete shkak pjesa e siperme e rruges nuk furnizohet me uje.

### **Burimi:**

Rezervuaret e ujit te qytetit Elbasan

### **Transmetuesi kryesor:**

Tubacioni kryesor, nga tubi Dj 200 PE merret nje degezim Dj 90PE deri tek pompa e ujit.  
L=25m

### **Ruajtja:**

Nuk ka rezervuar per ruajtjen e ujit por furnizohet nga rezervuaret kryesore te qytetit qe ndodhen ne Kraste te Madhe

### **Trajtimi/Dizinfektimi:**

Trajtimi behet me hipoklorit- natriumi ne rezervuar

### **Shperndarja:**

- Nga pompa uji dergohet direkt ne rrjetin shperndares

## **II.-Detyra e projektimit**

### **Te dhena e detyres se projektimit**

a- Rikonstruksion ujesjellesi, Zevendesim i rrjetit kryesor dhe atij shperndares, ndertim depo uji, Lagjia Dyli Haxhire, Rruga Kongresi i Permetit

nepermjet kerkesave kryesore :

*Relacion Teknik*

*2019*

Numri i popullsise ne vitin 2019 eshte :

**170 familje ose 1000 banore.**

Norma e perdorimit te ujit per banore te merret **150 l/dite/banore** dhe per objektet social kulturore **5 %** e konsumit te popullsise

Rritja natyrale demografike e popullsise **0.5 %** ne vit

Perspektiva e ujesjellesit **25** vjet

Burimi i furnizimit me uje jane Rezervuaret e qytetit

**Kerkesat e detyres se projektimit**

Rikonstrukcion ujesjellesi, Zevendesim i rrjetit kryesor dhe atij shperndares, ndertim depo uji, Lagjia Dyli Haxhire, Rruga Kongresi i Permetit.

**Projekt zbatimi duhet te perfshije keto materiale tekniqe :**

1. Planimetri aksiale te linjes kryesore te ujesjellesit nga pika qe do te rikostruktobet deri ne depon e ujit shkallen 1:1000 , 1: 2500 ose 1: 5000
2. Profil gjatesor i linjes kryesore dhe shperndarese.
3. Relacioni tekniko ekonomik i projektit duhet te perfshije pershkrimi i gjendjes ekzistuese te ujesjellesit, studimin sot te linjes kryesore, konkluzionet e projektuesit.
4. Preventivi i plete i zbatimit te punimeve i vleresuar me cmimet e tregut sot ku perfshihen edhe taksat ne fuqi dhe T.V.SH 20 %.
5. Problemet e ndryshme sociale, problemet e pronesise per vendin e ndertimit te kanaleve te ujesjellesit dhe lejet e ndertimit do te merren nga Sh.a. UKE.

**III.- Zhvillimi i projektit per rikonstruksion ujesjellesi**

- Bazuar ne detyren e projektimit eshte percaktuar numri i popullsise ne perspektive dhe sasia e ujit te fijshem per banoret dhe per objektet social kulturore, tregetare etj. Sipas kesaj detyre projektimi, popullsia ne vitin 2019 eshte 1000 banore, Ne perspektiven 25 vjecare me shtese popullsie 0.5 % ne vit sipas detyres projektimit numri i banoreve do te jete :

Npersp. =  $1000 (1 + 0.5 \%) 25 = 1.13 * 1000 = 1130$  banore. Pranojme **Npersp=1130 banore**

#### - Percaktimi i sasise mesatare te ujit

Per percaktimin e sasise mesatare te ujit, nga detyra e projektimit eshte dhene normativa e perdorimit te ujit per popullaten 150 l/dite/banor dhe per objektet social kulturore, tregetare, etj 5 % e konsumit te popullsise.

**Sasia mesatare ditore** e ujit sipas detyres projektimit do te jetë

- QmesS  $1130 * 150 : 86400 = 1.96$  l/sek neto dhe me humbjen 20 % ne rrjetin e jashtem dhe ate shperndares do te jetë QmesF =  $1.96 * 1.2 = 2.35$  l/sek.
- QmesEnte =  $2.35 * 5 \% = 0.12$  l/sek
- $\Sigma Qmes = QmesS + QmesE = 2.35 + 0.12 = 2.47$  l/sek  **$\Sigma QmesS + E = 2.47$  l/sek**

#### - Volumi I depos

Volumi I depos do te llogaritet per prurjen mesatare  $q = 2.47$  l/sek =  $213$  m<sup>3</sup>/24ore

$V_{depos} = V_{rreg} + V_{rezerve}$ ; Vrezerve = per 4 ore

$V_{depos} = 90/100 * 213/3 + 213 * 4/24 = 63.9 + 35.5 = 99.4$  m<sup>3</sup>

Pranojme  **$V_{depos} = 100$  m<sup>3</sup>** e cila do te jetë ne kuoten 173m.

#### -Koha e mbushjes se rezervuarit

$T_{mb} = V_{depos} : Q_{mes} = 100.000 L : 2.47 L/sek = 40486$  sek ~ 11.2 ore,  **$T_{mb} = 11.2$  ore**

Meqenese pompa punon maksimumi vetem 2 ore paradigmë dhe 2 ore pasdite ne 24 ore

atehere Q e saj duhet te jetë:  $100/3.6/2 = 13.89$  l/s

$Q_{nev.p} = 13.89$  l/s.

Nga llogaritjet Pompa duhet te kete keto parametra:

**$N = 15$ KW,  $Q = 14$  l/s dhe  $H_{min} = 65$ m.**

#### Llogaritjet hidraulike per rrjetin shperndares NSHU:

#### - Sasia maksimale ditore e ujit per rrjetin shperndares do te jetë:

$$Q_{\max}=2.47 \text{ l/s} * 2.0 = 4.94 \text{ l/sek.}$$

### **-Studimi i projektit te ujesjellesit**

Per studimin e rikonstrucionit te rrjetit shperndares te ujesjellesit, fillimisht u njohem me planimetrine e per gjithshme te zones si dhe me tubot e ujesjellesit ekzistues. Morem kontakt me punonjesit e Bashkise Elbasan dhe ata te sh.a. UKE Elbasan.

### ***Te dhenat topografike***

Ujesjellesi do te ndertohet ne një relief me pjerresi qe varion nga 0-10 % dhe fillon nga pikë e lidhjes ne tubacionin PE Dj 200 deri ne depo e re te ujit qe do te ndertohet. Rrjeti shperndares do te furnizohet me gravitet nga depo e re 100m<sup>3</sup>.

### ***Skema e funksionimit te ujesjellesit***

Skema e funksionimit te ujesjellesit eshte me ngritje mekanike deri ne depon e re 100 m<sup>3</sup> NSHU dhe me pas me vetterjedhje per rrjetin shperndares qe do te ndertohet i ri.

### ***Dimensionimi I tubacioneve te rrjetit Kryesor***

Sipas llogaritjeve te bera nga ana jone per kete ujeselles jane ruajtur presionet ne rrjetin kryesor jo me shume se 10 atm.

### **Emertimi Njesia Sasia**

F.V.Tubo PEHD, dn 160, PE 100, PN 10 ml 685

### **Gjithsej ml 675**

### ***Dimensionimi I tubacioneve te rrjetit shperndares***

Sipas llogaritjeve te bera nga ana jone per kete ujeselles jane ruajtur presionet ne rrjetin shperndares jo me shume se 10 atm

Nga llogaritjet hidraulike per dimensionimin e tubacioneve duke u bazuar ne planimetrite e dhena ne detyren e projektimit, duhen keto tubacione :

## **Zona NSHU:**

### **Emertimi Njesia Sasia**

F.V.Tubo PEHD, dn 90, PE 100, PN 10 ml 276

F.V.Tubo PEHD, dn 63, PE 100, PN 10 ml 231

F.V.Tubo PEHD, dn 50, PE 100, PN 10 ml 167

F.V.Tubo PEHD, dn 40, PE 100, PN 10 ml 349

F.V.Tubo PEHD, dn 32, PE 100, PN 10 ml 329

F.V.Tubo PEHD, dn 25, PE 100, PN 10 ml 93

F.V.Tubo PEHD, dn 20, PE100, PN 10 ml 1010

**Gjithsej ml 2455**

### **-Konkluzione**

Nga verifikimet ne vend dhe nga llogaritjet konkludojme si me poshte :

1. Eshte i domosdoshem rikonstruksioni i linjes kryesore dhe linjave shperndarese te ujesellesit te rruges Kongresi i Permetit Lagjja Dyli Haxhire pasi rrjeti ekzistues. eshte i amortizuar dhe nuk furnizon nje pjese te mire te banoreve.
2. Ne projekt eshte respektuar kryesisht traseja e rrugeve per te mos patur problem. me pronaret perjashto ndonje pjese te vogel ku nuk ka mundesi tjeter per te kaluar.
3. Gjate dimensionimit te tubacioneve te rrjetit shperndares eshte ruajtur presioni deri ne 10 atm.

### **.-Rekomandime**

- Me pare te filloje ndertimi i rrjetit dhe ne fund te behet lidhja e ujit per te mos krijuar probleme te medha ne furnizimin me uje.
- Rekomandojme qe perpara se te filloje zbatimi i punimeve te meret leja e ndertimit si dhe leja tek pronaret e tokave per kanalet.



### **-Preventivi i vepres**

Ne baze te detyres se projektimit jane preventivuar punimet sipas konkluzioneve tona te mesiperme duke u bazuar ne çmimet e tregut shqiptar..

Preventivi i zbatimit te punimeve i vleresuar me cmimet e tregut sot dhe me struktura preventivi + T.V.SH 20 % eshte **15,171,518 leke.**

Projektues

**Ing. Hidroteknik Dashamir Peqini**

